




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/79
Datë: 11.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Lojërat e Fatit.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Financave/Ministarstv za Finansije/ Ministry of Finance

KONCEPT DOKUMENT PËR
LOJËRAT E FATIT

Përgatitur nga : **MINISTRIA E FINANCAVE**

Shtator 2018

PËRMBAJTJA

Përmbledhje e koncept dokumentit.....	3
Hyrje.....	5
Kapitulli 1- Përkufizimi i problemit.....	7
Kapitulli 2- Objektivat.....	12
Kapitulli 3- Opsionet.....	14
3.1. Opsioni pa ndryshime.....	14
3.2. Ndryshimi i politikës.....	14
3.3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit.....	21
Kapitulli 4- Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme.....	23
Kapitulli 5- Komunikimi dhe konsultimi.....	26
Kapitulli 6- Krahasimi i opsioneve.....	28
Kapitulli 7- Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	31
Shtojcat.....	32

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Figura1: Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT
Ministria bartëse	Ministria e FINANCAVE
Personi kontaktues	Isen LIPOVICA, tel. 038 200 25500 e-mail: Isen.lipovica@atk-ks.org
PVPQ	<p>Përgatitja e Koncept Dokumentit për Lojërat e Fatit,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në PVPQ 2018 në kuadër të Prioritetit Strategjik të Qeverisë Nr.1. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit • Objektiva5-Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes përmes rritjes së efikasitetit të ofrimit të shërbimeve, sistemit të inspektimeve shtetërore dhe zvogëlimit të pengesave administrative për biznese; • Aktiviteti 1.5.2.-Hartimi i Koncept dokumentit për trajtimin Lojërave të Fatit, Koncept Dokumenti i aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës.
Prioriteti strategjik	<p>Përgatitja e KD për Lojërat e Fatit në kuadër të PKZMSA, në Masat Zbatuese, aktiviteti 3.17.2. përmes së cilit synohet të arrihen këto objektiva strategjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ulja e informalitetit; • Përshpejtimi i zhvillimit ekonomik përmes rritjes së të hyrave buxhetore; • Përmirësimi i klimës së të bërit biznes në Kosovë.

Vendimi	
Çështja kryesore	Vështirësitë në zbatimin e ligjit në praktikë
Përmbledhje e konsultimeve	<p>Grupi punues ka arritur të realizoj një komunikim dhe konsultim të brendshëm, duke bërë komunikimin e qëllimeve të Qeverisë për përmirësimin ose ndryshimin e legjislacionit, arsyet dhe motivet që qëndrojnë pas këtyre qëllimeve. Në këtë rast, vlen të theksohet posaqërisht komunikimi dhe konsultimi me Departamentin e Lojërave të Fatit në kuadër të ATK-së.</p> <p>Gjithashtu, grupi punues ka realizuar komunikim dhe konsultim konstruktiv edhe me bizneset që afektohen nga ky Koncept dokument, përmes takimeve të drejtpërdrejta apo përmes komunikimit elektronik të Personit Përgjegjës me drejtorin e “Lotaria e Kosovës” Sh.a si dhe me kryetarin e Shoqatës së Lojërave të Fatit, me qëllim që grupi të informohet me propozimet, vërejtjet dhe rekomanimet e tyre, në funksion të eliminimit të dobësive të ligjit aktual.</p> <p>-Lotaria e Kosovës” Sh.a. -Shoqata e Lojërave të Fatit</p>
Opsioni i propozuar	Opsioni 2: Ndryshimi i politikës

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Zbatohet në kuadër të kufijve aktual buxhetor
Ndikimet ekonomike	Ndikimet ekonomike do të shprehen përmes: <ul style="list-style-type: none"> • Rritjes së numrit aktual të vendeve të punës, • Rritjen e numrit të bizneseve të reja, • Uljen e ngarkesave administrative për bizneset, • Investimeve të huaja direkte, • Konkurrencës lojale në treg, • Rritjes së përgjithshme ekonomike.
Ndikimet shoqërore	Ndikimet shoqërore do të shprehen përmes: <ul style="list-style-type: none"> • Uljes së shkallës së papunësisë, • Ngritjes së mirëqenies së përgjithshme, • Mundësive më të mëdha për investime në skema sociale, edukim, sport, siguri dhe shëndetësi publike, etj. • Uljes së përgjithshme të kriminalitetit, dhunës në familje, etj.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori
Ndikimet ndër-sektoriale	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori
Ngarkesat administrative për kompanitë	Nuk vlen
Testi i NVM-ve	Nuk ishte i nevojshëm

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hartimi i akteve normative bazuar në këtë Koncept dokument
Afatmesëm	-Raportimi i qarkullimit nga ana e operatorëve në përputhje me kuadrin e ri ligjor, -Aplikimi i kritereve të reja për (ri) licencim

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Hyrje

Ky Koncept Dokument është i bazuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2017-2021 si dhe Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare për periudhën 2014-2018.

Dokumentet e sipërpërmendura paraqesin bazën në të cilat është mbështetur edhe Vendimi i Ministrisë së Financave (MF) për themelimin e Ekipit Përgjegjës për hartimin e këtij Koncept dokumenti.

Qeveria zotohet se, në baza të rregullta vjetore, buxheti do të rritet në linjë me rritjen ekonomike të vendit. Për më tepër, dhe si shtesë nga rritja ekonomike, buxheti do të shtohet edhe si rezultat i zvogëlimit të hendekut tatimor, respektivisht masave përkatëse për reduktimin e informalitetit.

Në këtë linjë, kërkohet përmirësim i vazhdueshëm i legjislacionit tatimor duke përfshirë edhe dispozitat që rregullojnë lëmin e aktiviteteve të lojërave të fatit.

Andaj, me qëllim të adresimit të problemeve me të cilat ballafaqohen tatimpaguesit dhe institucionet e zbatimit të Ligjit, përfshirë këtu edhe problemet përmbajtësore dhe ato teknike të ligjit aktual në fuqi për Lojërat e Fatit dhe të sfidave që lindin për harmonizimin e mëtejme të tij me legjislacionin e BE-së dhe praktikat ndërkombëtare, Ministria e Financave ka themeluar Grupin Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Ligjin për Lojërat e Fatit, në përbërje me përfaqësues nga: Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe zyrtarë nga Ministria e Financave.

Figura2. Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT
Ministria bartëse	MINISTRIA E FINANCAVE
Personi kontaktues	Isen LIPOVICA, tel.038 200 255 00 e-mail: Isen.Lipovica@atk-ks.org
PVPQ	Përgatitja e Koncept Dokumentit për Lojërat e Fatit, në PVPQ 2018 në kuadër të Prioritetit Strategjik të Qeverisë Nr. 1. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit Objektiva 5. Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes përmes rritjes së efikasitetit të ofrimit të shërbimeve, sistemit të inspektimeve shtetërore dhe zvogëlimit të pengesave administrative për biznese;

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

	<p>Aktiviteti 1.5.2. Hartimi i Koncept dokumentit për trajtimin e Lojërave të Fatit, Koncept Dokumenti i aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës.</p>
<p>Prioriteti strategjik</p>	<p>Përgatitja e KD për Lojërat e Fatit në kuadër të PKZMSA, në Masat Zbatuese, aktiviteti 3.17.2. përmes së cilit synohet të arrihen këto objektiva strategjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ulja e informalitetit , • Përsheptim të zhvillimit ekonomik përmes rritjes së të hyrave buxhetore • Përmirësimi i klimës të të bërit biznes në Kosovë.
<p>Grupi punues</p>	<p>Administrata Tatimore e Kosovës :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Isen Lipovica –Drejtor Operativ Rajonal, Prishtina1; 2. Flurim Kurtishaj- Drejtor Dep. Lojërat e Fatit; 3. Fadil Revuçi- Menaxher, Dep. Shërbime Juridike; 4. Sevdie Kadriu- Zyrtare Ligjore për Legjislacion dhe Këshilla Juridike; 5. Ardita Blaku- Zyrtare Ligjore për Legjislacion dhe Këshilla Juridike; 6. Sadat Uka- Udhëheqës Ekipi i Lojërave të Fatit, DLF 7. Bashkim Paçarizi- Udhëheqës Ekipi i Lojërave të Fatit, DLF <p>Doganat e Kosovës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fisnik Nuli <p>Ministria e Financave:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nexhip Gashi- Zyrtar i Lartë për Politika Fiskale 2. Bahrije Berisha- Zyrtare Ligjore 3. Diellëza Arifi – Zyrtare e Lartë për Integrim Evropian 4. Antigona Prenaj- Analiste e Lartë e Buxhetit
<p>Informata shtesë</p>	

KAPITULLI 1 PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Aktualisht, Lojërat e Fatit në Kosovë rregullohen me ligj të veçantë, gjegjësisht me Ligjin Nr. 04/L-080 Për Lojërat e Fatit dhe me Udhëzimin Administrativ MF-Nr. 03/2013 Për Zbatimin e Ligjit Nr. 04/L-080 Për Lojërat e Fatit.

Sipas ligjit të sipërpërmendur, autoritet rregullator i lojërave të fatit në Kosovë është Administrata Tatimore e Kosovës. Mirëpo, asgjë nga ky ligj nuk duhet interpretuar si ndalim ose kufizim i autoritetit të agjencive vendore të zbatimit të ligjit për të forcuar dispozitat e këtij ligji ose akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, si: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe organet e qeverisjes lokale.

Legjislacioni tatimor aktual në fuqi, megjithëse përcakton kategoritë e lojërave të fatit të lejuara, kushtet, kriteret dhe procedurat që rregullojnë këtë veprimtari në Republikën e Kosovës si dhe detyrat, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit, dispozita të caktuara të tij janë nxitëse të shmangies së obligimeve dhe pengesë për përmbushjen vullnetare të tatimeve.

Vlen të theksohet se ligji aktual nuk është hartuar në përputhje me standardet e kërkuara përmes Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 Për Standardet e hartimit të akteve normative.

Legjislacioni aktual shoqërohet me probleme që derivojnë nga mangësitë ligjore dhe rregullative. Kjo ndodh për arsye se dispozita të caktuara të ligjit nuk zbatohen si duhet, janë të pakompletuara dhe shkaktojnë ngarkesa të panevojshme.

Nga sa u tha më lartë, është konstatim i përgjithshëm se **problemi kryesor është rritja e informalitetit dhe shmangia tatimore që derivon nga sfida e zbatimit në praktikë të ligjit aktual.**

Aktualisht, Operatorët e licencuar për lojëra të fatit janë të shtrirë në gjithë territorin e vendit, të shtyrë nga kriteret teknike për licencim (distanca nga institucionet shtetërore, edukative, fetare, distanca mes vete, etj.).

Kjo situatë vështirëson efikasitetin e organeve të zbatimit të ligjit dhe krijon mundësi reale për shmangie tatimore dhe moszbatim të rregullave të përcaktuara me ligj.

Operatorët e lojërave të Fatit, përveç obligimit tatimor të përcaktuar me ligjet përkatëse janë të detyruar të paguajnë edhe akcizë mujore për çdo aparat në dispozicion dhe taksë komunale për ushtrim të aktivitetit.

Shkaqet e problemit, në rastin konkret ndërlidhen me:

- Mangësitë ligjore dhe rregullative; dhe
- Çështjet shoqërore.

Mangësitë ligjore konsistojnë në:

- **Rregullat e paqarta-** ekzistojnë rregulla dhe kritere në ligjin aktual për të cilat edhe pse ka interpretime ligjore përsëri ngelet hapësirë për paqartësi, si p.sh. distancat e nevojshme nga objektet shkollore, fetare etj.;
- **Rregullat shkaktojnë ngarkesa të panevojshme** -distanca mes lokaleve të lojërave të fatit konsiderohet që është absolutisht e panevojshme;
- **Kriteret e vështira për operatorët e LF** - procedurat e licencimit dhe afati i shkurtër i licencave krijojnë vështirësi të theksuara për afarizmin e bizneseve;
- **Rregullat janë të vjetruara** (legjislacioni aktual kufizon aplikimin e lojërave online dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të Lotarisë së Kosovës);
- **Vështirësitë në inspektim** - mungesa e serverit përmes së cilit do të bëhej deklarimi online i qarkullimit të Operatorëve të licencuar krijon vështirësi në inspektim dhe mundësi për shmangie tatimore.
- **Perceptimi publik negativ ndaj LF** – vështirësitë që rrjedhin nga kuadri ligjor aktual që janë manifestuar me efekte të natyrave të ndryshme kanë ndikuar në krijimin e perceptimit negativ tek masat e gjera;

Efektet (pasojat) që ka shkaktuar kuadri aktual ligjor, janë :

- **Rritja e kriminalitetit-** në mungesë të perspektivës reale shumica e lojtarëve “perspektivën” e kërkojnë tek lojërave të fatit. Kjo kategori e qytetarëve rëndom qëndron keq me të ardhura dhe ka prirje për vepra kriminale.
- **Siguria e rrezikuar e qytetarëve** – mungesa e perspektivës së qartë është burim i pasigurisë qytetare,
- **Problemet familjare** –kategoria e qytetarëve që kanë imagjinatë të pasur si rezultat i realitetit të varfër, janë kandidatë potencial për ushtrimin e dhunës në familje.
- **Numri i madh i vetëvrasjeve** – mungesa e perspektivës shpeshherë shpie në fund tragjik-vetëvrasje;
- **Investime të huaja modeste** – duke pasur parasysh vështirësitë në zbatimin e ligjit dhe perceptimin negativ është evidente që investimet e huaja të jenë në nivele modeste;

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

- *Të hyra buxhetore të humbura- për shkak të nxitjes për shmangie dhe evazion fiskal, për arsytet e sipërpërmendura;*
- *Zhvillimi i ulët ekonomik –shkaqet e lartpërmendura nuk lejojnë që aktivitetet e lojërave të fatit të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik. Përkundrazi, efekti i tyre është negativ.*

Grupi punues vlerëson që zgjidhja e problemeve ekzistuese mund të bëhet përmes kuadrit të ri ligjor, i cili duhet të jetë lehtë i kuptueshëm dhe zbatueshëm për të gjithë akterët që afektohen prej tij.

Kuadri i ri ligjor do të jetë në interes të :

- Qeverisë së Kosovës në funksion të:
 - përmirësimit të klimës së të bërit biznes,
 - rritjes së të hyrave buxhetore, dhe
 - uljes së papunësisë;
- Administratës Tatimore të Kosovës :
 - për të përmbushur përgjegjësitë e saj ligjore si dhe
 - për të luftuar in-formalitetin;
- Lotarisë së Kosovës,
- Operatorëve të licencuar për Lojëra të Fatit në Kosovë, dhe
- Organeve të zbatimit të ligjit.

Në tabelën në vijim janë pasqyruar : palët e interesuara, shkaqet, efektet dhe ndërlidhja me shkaqet/efektet.

Figura 1: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala	Efekti-et me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Qeveria e Kosovës	Informaliteti	Të hyrat buxhetore	Nuk i ka kryer obligimet që rrjedhin nga ligji aktual
Administrata Tatimore e Kosovës	Zbatimi i drejtë dhe njëtrajtshëm i ligjit për të gjithë tatimpaguesit	Realizimi i objektivave	Nuk ka mundur raportimin online të qarkullimit të realizuar
Lotaria e Kosovës	Mospresenca në tregun rajonal		Mungesa e kuadrit adekuat ligjor
Operatorët e licencuar për LF (Shoqata e LF)	Mosdefinimi i qartë i kriterëve teknike për licencim	Afati i shkurtër i licencave	Nxitja për shmangia tatimore
Komunat		Mbrojtja e interesit qytetar	Mosdefinimi i qartë i kriterëve teknike për licencim
	Kriminaliteti		

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Policia e Kosovës	ekonomik	Siguria e qytetarëve	Kompetencat jo të qarta
Dogana e Kosovës		Realizimi i objektivave	Përgjegjësia për të hyrat nga akciza

Figura5: Aktivitetet e Departamentit të Lojërave të Fatit gjatë vitit 2015 dhe 2016

Përshkrimi	2015	2016
Revokim i licencave	2	-
Lëshim i licencave	-	1
Vlera për licencë	-	5,500
Vazhdim i licencave	33	5
Vlera për vazhdim licence	71,000	9,500
Zgjerim aktiviteti	-	7
Vlera për zgjerim	-	81,250
Te hyrat nga depozitat	-	-
Gjithsej - numri i licencave dhe zgjerimeve	33	13
Gjithsej - vlera e licencave dhe zgjerimeve	71,000	96,250
Gjithsej - revokimi i licencave dhe zgjerimeve	2	-
Kërkesa për organizim të lojërave shpërblyese	39	-
Numri i gjobave të lëshuara	31	225
Gjithsej- vlera e gjobave të lëshuara	115,000	528,350

Burimi: ATK - Raporti vjetor i punës 2015 dhe 2016

Figura6: Aktivitetet e Departamentit të Lojërave të Fatit gjatë vitit 2017

Lloji i vizitës	Nr. i vizitave	Nr. i punëtorve	Qarkullimi shtesë	Tatimi shtesë	Ulje e kreditimit	Zvogëlim i humbjes
Vizita rimbursive	2	-	-	-	-	-
Edukative	2	-	-	-	-	-
Mbledhja e informative	70	-	-	-	-	-
Besueshmëria e dokumentacionit	103	12	1,865,350			
Vëzhguese	155	-	-	-	-	-
Vizitat me polici	68	-	-	-	-	-
Lëshimi i numrit fiskal	2	-	-	-	-	-
Kontakte në zyrë	25	-	85,875	430	-	17,841
Vizita të tjera	859	-	147,520	14	-	14
TOTALI	1,286	12	2,098,745	64,566	24,883	141,781

Burimi: ATK-Raporti vjetor i punës 2017

KAPITULLI 2 OBJEKTIVAT

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2017-2021 si dhe Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, janë dokumentet bazë në të cilat është mbështetur Vendimi i Ministrisë së Financave (MF) për themelimin e Ekipit Përgjegjës për hartimin e këtij koncept dokumenti.

Me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës, Shtylla e dytë (II) e Programit të Qeverisë, për periudhën 2017-2021 ka përcaktuar si prioritete:

- Zhvillimin ekonomik, dhe
- Punësimin.

Zhvillimi i hovshëm dhe i qëndrueshëm ekonomik i mbështetur në potencialin njerëzor dhe pasuritë natyrore të Kosovës është boshti i këtij programi qeverisës.

Programi qeverisës ka përcaktuar këto objektiva stratexhike:

- Ekonomi të zhvilluar dhe modernizim të shtetit si dhe
- Integritime euro-atlantike të vendit.

Zhvillimi i përshpejtuar ekonomik do të mundësonte:

- rritjen e mirëqenies së qytetarëve,
- hapjen e vende të reja të punës,
- zhdukjen e varfërisë ekstreme në Kosovë,

dhe i njëjti do të arrijë përmes rritjes së qëndrueshme ekonomike me normë mesatare prej pesë (5) deri në shtatë për qind (7%).

Për të arritur këto norma që tejkalojnë substancialisht mesataren e viteve të fundit, Qeveria do të fokusohet në implementimin me sukses të pesë (5) reformave që kanë ndikim direkt në përmirësimin e ambientit ekonomik, fiskal dhe financiar. Masat programore pritet të rezultojnë në rritje të aktivitetit ekonomik, sidomos në industrinë prodhuese, përpunuese dhe atë të shërbimeve, duke mbështetur zgjerimin e eksporteve, zvogëlimin e importeve dhe rrjedhimisht përmirësimin e bilancit tregtar të vendit.

Që të arrihet ky synim i qeverisë, i shprehur me programin e saj të punës për periudhën 2017-2021, është e domosdoshme të përmirësohet edhe legjislacioni, i cili do të krijonte mundësi për zhvillimin më të hovshëm dhe klimë më të mirë të të bërit biznes në Kosovë, përmes:

- rritjes së efikasitetit të ofrimit të shërbimeve,
- sistemit të inspektimeve shtetërore dhe
- zvogëlimin të pengesave administrative për bizneset.

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Në funksion të realizimit të prioriteteve të mësipërme, Ministria e Financave ka vendosur të krijoj Grupin Punues për rishikimin e kuadrit ligjor në fushën e tatimeve direkte dhe indirekte në Kosovë, në mënyrë që propozimet e bëra të jenë në funksion të zbatimit më të drejtë dhe më të lehtë të ligjeve tatimore dhe procedurave, nga ana e tatimpaguesve dhe Administratës Tatimore, në funksion të përmbushjes vullnetare të tatimeve, duke:

- Sistematizuar strukturën dhe përmbajtjen;
- Ndryshuar dispozitat e nevojshme;
- Korrigjuar gabimet teknike; dhe
- Adaptuar legjislacionin sekondar.

Në kuadër të rishikimit të legjislacionit tatimor në përgjithësi, MF e vlerëson të domosdoshëm edhe rishikimin e Ligjit për Lojërat e Fatit, duke pretenduar që i njëjti të jetë në funksion të përmbushjes tatimore nga ana e tatimpaguesve, posaçërisht përmbushjes së detyrimeve tatimore në mënyrë vullnetare.

Ky qëllim i përcaktuar, synohet të realizohet përmes tri objektivave:

- Sistematizimi i duhur i dispozitave ligjore në fuqi;
- Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit me rekomandimet e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare; dhe
- Evitimi i pengesave në zbatimin e legjislacionit tatimor në përgjithësi.

Realizimi i sukseshëm i këtyre objektivave do të rezultonte me rritjen e të hyrave buxhetore, si rezultat i eliminimit të evazionit fiskal, zvogëlimit të ekonomisë informale dhe rritjes së aktiviteteve ekonomike investuese, prodhuese dhe eksportuese, pa ndonjë rritje të normave të tatimeve dhe doganave, por duke bërë shtrirjen horizontale të sistemit fiskal.

Njëherit, do të sigurohej edhe vazhdimësia e përmirësimit të mjedisit të të bërit biznes.

Figura 7: Objektivat relevante të Qeverisë

Objektivi relevant	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Ekonomi të zhvilluar dhe modernizim të shtetit	Programi i Qeverisë 2017-2021
Integritet euro-atlantike të vendit	Programi i Qeverisë 2017-2021

Ndërsa, **objektiva specifike**, përmbushjen e të cilëve do të mundësonte kuadri i ri ligjor, janë:

- Ulja e informalitetit për pesëdhjetë përqind (50 %) deri në fund të vitit 2021;
- Rritja e të hyrave tatimore nga Lojërat e Fatit për pesëdhjetë përqind 50 % deri më 2021.
- Përqindja e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore, deri në fund të vitit 2021 të jetë mbi mesataren e përgjithshme në nivel të ATK-së.

KAPITULLI 3 OPSIONET

3.1. Opsioni 1

Opsioni pa ndryshime (gjendja status quo)

Mosndryshimi i Ligjit për Lojërat e Fatit do të nënkuptonte vazhdimin e status quo-s së tanishme që do të thotë, vazhdim i zbatimit të një ligji i cili ka mangësi të natyrës teknike- në mënyrën e hartimit e tij, dhe juridike - në zbatimin e tij.

Ligji aktual nuk është hartuar sipas standardeve të hartimit të akteve normative, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2013- Për Standardet e hartimit të akteve normative.

Shkaku i të metave të sipërpërmendura, shpeshherë hasim në dispozita të cilat janë të panevojshme apo edhe krijojnë ç'orientim në zbatimin e tyre brenda përbrenda vet dispozitës, të cilat manifestohen me vështirësi dhe joefikasitet për institucionet e ndryshme në të cilat ka ndikim ligji, si : ATK, Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës dhe komunitat.

Gjithashtu, zbatimi i dispozitave të ligjit në fjalë përbënë sfida edhe për bizneset e Lojërave të Fatit, e cila manifestohet me nxitjet për shmangie tatimore.

Mosndryshimi eventual i ligjit do të nënkuptonte faktin që edhe më tutje të vazhdohet me mangësitë e përmendura të cilat nuk janë në funksion të luftimit të ekonomisë joformale, të përcaktuar si objektiv strategjik i Qeverisë.

3.2. Opsioni 2

Ndryshimi i politikës

Ndryshimi i politikës ekzistuese bëhet duke hartuar kuadrin e ri ligjor për Lojërat e Fatit, përmes të cilit do të përcaktoheshin kriteret dhe procedurat për fushëveprimin e Lojërave të Fatit në Kosovë.

Hartimi i infrastrukturës së re dhe të përshtatshme ligjore do të ndikonte në kontrollin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të lojërave të fatit nga ana e organeve të zbatimit të ligjit, me ç'rast aktiviteti në fjalë do të vëhej në funksion të drejtpërdrejtë të zhvillimit ekonomik të vendit. Pra, me anë të një baze ligjore të mirëfilltë dhe kontrolluese nga ana e institucioneve përgjegjëse do të eliminoheshin dobësitë e sipërpërmendura të kuadrin ekzistues ligjor si dhe paragjykimet shoqërore, të nderlidhura me perceptimin publik për bizneset që i takojnë kësaj fushe.

Gjithashtu, kuadri i ri ligjor do të mundësonte:

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

- Hartimin e tij në përputhje me kërkesat standarde të Udhëzimit për hartimin e akteve normative;
- Eliminimin e dispozitave ligjore:
 - jo të plota,
 - kontradiktore ,dhe
 - atyre që krijojnë ngarkesa të panevojshme (të ndërlidhura me procedurat e licencimit dhe rilicencimit).

Elementet kryesore të politikës së propozuar që duhet të trajtohen përmes Ligjit të Ri për Lojërat e Fatit do të përqendrohen në aspektin përmbajtësor dhe në atë teknik. Disa nga ndryshimet përmbajtësore të kërkuara, por duke mos u limituar, janë si në vijim:

1. Neni 1 - Qëllimi,

- duhet t'i paraprij neni që përcakton **Objektin e ligjit** duke potencuar që ky ligj përcakton kategoritë e lojërave të fatit të lejuara, kushtet, kriteret dhe procedurat që rregullojnë këtë veprimtari në Republikën e Kosovës, si dhe detyrat, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit.
- duhet të pasohet me nenin **Fusha e zbatimit**. Përmes këtij neni do të përcaktoheshin subjektet në të cilat ky ligj ka ndikim.

2. Neni 2- nuk është titulluar.

Neni 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 (në tekstin në vazhdim U.A. Nr. 03/2013) Për Standardet e hartimit të akteve normative, përcakton që secili nen duhet të ketë titullin.

- Meqë neni në fjalë përcakton parimet themelore të ndërlidhura me lojërat e fatit, propozojmë që neni të titullohet **Parimet Themelore**.

3. Neni 3, Përkufizimet- duhet të riformulohet me qëllim të ofrimit të përkufizimeve sa më të plota dhe të sakta si dhe zgjerimit të përmbajtjes së përkufizimeve. Posaçërisht, janë identifikuar për riformulim paragrafët:

- 1.2. Aplikim,
- 1.4. Automati,
- 1.5. Basti ,
- 1.8. Lojërat numerike,
- 1.10. Lojërat e lotarisë,
- 1.12. Bordi menaxhues,
- 1.23. Licenca për lojërat e fatit,
- 1.25. Kazino,
- 1.40. Bingo televizive,
- 1.41. Lojëra elektronike të fatit
- 1.42. Video-lotari
- 1.43. Zonë e lirë.

4. Neni 4, Lojërat e fatit – licencimi, kategorizimi dhe rregullimi,

- duhet të riformulohet paragrafi 4 i nenit duke e ndarë në dy (2) nën-paragrafë me ç'rast, nën-paragrafi 4.1 do të përcaktonte të drejtën dhe autoritetin e ATK-së për rregullimin e lojërave në kazino ndërsa nën-paragrafi 4.2 do të përcaktonte autorizimet e bizneseve të licencuara për lojëra në kazino.
- Paragrafi 5 i nenit duhet të rishqyrtohet.
- Gjithashtu, duhet të shtohet paragrafi i ri (paragrafi 6) me këtë përmbajtje:

Lojërat e lotarisë mund të organizohen online dhe në mënyrë elektronike.

5. Neni 5 - Lojërat zbavitëse dhe konkurset shpërblyese,

- Duhet të riformulohet paragrafi 3 duke u ndarë në dy paragrafë (paragrafin 3 dhe paragrafin 4) në mënyrë që të bëhet i qartë dallimi në mes të natyrës së shpërblimit dhe mënyrës së pagesës.
- Paragrafi 4 bëhet paragraf nr.5.

6. Neni 6 - Publiciteti i lojërave të fatit dhe ushtrimi i aktivitetit të tyre në zona të lira-

- duhet të riformulohet paragrafi 1 duke e ndarë në katër (4) nën-paragrafë ndërsa paragrafi 3 i nenit duhet të përfshihet në nën-paragrafin 1.4 të po këtij neni.

7. Nenet 7-11 nuk janë titulluar.

- Neni 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 (në tekstin në vazhdim U.A. Nr. 03/2013) Për Standardet e hartimit të akteve normative, përcakton që secili nen duhet të ketë titullin.

8. Neni 7 – i referohet Lotarisë së Kosovës por:

- duhet titulluar,
- duhet riformuluar duke përcaktuar qartë:
 - statusin e subjektit juridik,
 - përgjegjësitë e Qeverisë së Kosovës si themeluese e Lotarisë dhe
 - lojërat e lotarisë të cilat mund të organizohen nga ky subjekt.

9. Neni 8 – i referohet Menaxhimit të Lotarisë së Kosovës por duhet titulluar dhe riformuluar duke përcaktuar qartë autoritetin mbikëqyrës të Lotarisë së Kosovës.

10. Neni 9 – i referohet Statutit Lotarisë së Kosovës por duhet titulluar.

11. Neni 10 – duhet të përcaktoj qartë kompetencat e Bordit Mbikëqyrës të LK.

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

12. **Neni 11-** duhet titulluar dhe meqenëse përcakton mënyrën e bashkëpunimit me lotaritë e shteteve të tjera, propozojmë:

- të titullohet “ Bashkëpunimi i LK me lotaritë e shteteve të tjera”.
- Paragraf 1 dhe paragrafi 4 i nenit 11 duhet të përfshihen në nenin 7 të ligjit.

13. **Neni 12 - Lojërat e lotarisë,**

- të riformulohet paragrafi 1 i nenit duke përcaktuar dhe kategorizuar lojërat e lotarisë që lejohen në bazë të ligjit të ri mbi Lojërat e Fatit në Republikën e Kosovës.

14. **Neni 13 - Rregullat e lojërave të lotarisë –**

- paragrafi 4 plotësohet, ndryshohet dhe merr këtë përmbajtje:

Lotaria e Kosovës është e detyruar që rregullat e lojërave të lotarisë t'i shpall publikisht para fillimit të organizimit të lojës në faqen zyrtare të saj, dhe personave të interesuar për pjesëmarrje në lojë të ju mundësoj që në pikat e shitjes t'i kenë në dispozicion (të njihen me) rregullat e lojës.

- Shtohet paragrafi 5 me këtë përmbajtje:

Kushtet për organizimin e përbashkët të lojërave të fatit me Lotaritë e shteteve të tjera dhe/apo me organizatat e specializuara, përcaktohen me rregullat e lojës, të cilat aplikohen pasi të merret pëlqimi nga Ministria e Financave.

15. **Neni 14 - Tërheqja e fitimeve -**

- Propozohet paragrafi i ri nr. 3. me këtë përmbajtje:

Në lojërat ndërkombëtare me organizim të përbashkët me Lotaritë e shteteve të tjera ku tërheqja e numrave ose simboleve bëhet jashtë Republikës së Kosovës, procesi i tërheqjes zhvillohet në pajtim me rregullat e shtetit në të cilin bëhet tërheqja.

- Propozohet paragrafi i ri nr. 4 me këtë përmbajtje:

Nëse tërheqja e numrave fitues bëhet me gjenerimin e numrave (sistemit random), mbikëqyrja e tërheqjes e përcaktuar në paragrafin 1 dhe paragrafin 2 të këtij neni, nuk aplikohet.

- Pas shtimit të dy paragrafëve të rinj, paragrafët aktual: 3;4;5 dhe 6, kalojnë si paragrafë: 5; 6; 7 dhe 8.

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

- *Paragrafi 6 duhet të riformulohet me qëllim që të përcaktohet mënyra dhe kushtet e revokimit të organizimit të lojës.*
16. **Neni 15 -s'ka titull, duhet të përfshihet në nenin 14**
17. **Neni 16 - Fondi i fitimeve dhe pagesat-**
- *propozohen dispozita shitesë që do të përcaktonin fondin e fitimit në lojërat ndërkombëtare, bazuar në rregullat përkatëse.*
 - *Gjithashtu, përcaktohet mënyra e pagesave për pjesëmarrje në lojërat e lotarisë.*
18. **Neni 17- s'ka titull, duhet rregulluar. Propozim "Pagesat për fituesit"**
19. **Neni 19 – Lotaria, në përputhje me U.A. Nr. 03/2013, paragrafët duhet të ndahen në nën-paragrafë**
20. **Neni 20 - Loto, keno dhe varianta të lojërave të tjera**
Duhet të riformulohet titulli dhe përmbajtja me qëllim të përcaktimit të mënyrës së tërheqjes së numrave fitues për lojërat ndërkombëtare që organizohen në bashkëpunim me Lotaritë e shteteve tjera.
21. **Neni 24 - Autoriteti i lojërave të fatit,**
- *propozim për titull të nenit: Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit;*
 - *përmbajtja e nenit të riformulohet duke përcaktuar përgjegjësinë për aktet nënligjore që rrjedhin nga ligji.*
22. **Neni 25 - Licencat e nevojshme – të riformulohet titulli :Licencat për lojërat e fatit**
- *Nën paragrafët: nga 1.1 deri në 1.6 të këtij neni duhet të ndahen në nën-nën paragrafë;*
 - *Paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni duhet të riformulohen me qëllim të eliminimit të paqartësive që përmbajnë aktualisht.*
23. **Neni 28 - Rezultatet e përshtatshmërisë - duhet të riformulohen me qëllim të përcaktimit të mënyrës së verifikimit të përshtatshmërisë.**
24. **Neni 31 - Licencat, regjistrimet dhe gjetjet e përshtatshmërisë
Të revokueshme – të patransferueshme,**

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

- *duhet të riformulohet paragrafi 1 dhe paragrafi 2 në mënyrë që të përmbushin kërkesat e U.A. Nr. 03/2013.*

25. Neni 33 - Plotësimi i kriterit të përshtatshmërisë

- *duhet të riformulohet përmbajtja e nenit në mënyrë që të përmbushen kërkesat e U.A. Nr. 03/2013.*

26. Neni 35 - Personat që ndalohet të kenë interes në lojërat e fatit

- *duhet të riformulohet përmbajtja e nenit në mënyrë që të përcaktohen qartë personat të cilëve u ndalohet të kenë interes në LF.*

27. Neni 36 - Aplikimi, kostoja dhe dorëheqja nga e drejta e fshehtësisë

- *Të riformulohet titulli dhe përmbajtja e nenit.*

28. Neni 38 - Aplikimi, autorizimi për hetime të historikut të aplikantit

- *Të riformulohet titulli dhe përmbajtja në mënyrë që të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e aplikantit dhe ATK-së, në një procedurë licencimi.*

29. Neni 39 - Shkarkimi nga përgjegjësia –nxjerrja e informacionit ose publikimet

- *Të riformulohet dhe të përfshihet si paragraf në nenin 38.*

30. Neni 40 - Rifreskimi i licencës, regjistrimi, gjetja e përshtatshmërisë apo leje tjetër

- *ishte dispozitë kalimtare dhe vlerësohet e panevojshme, prandaj duhet të fshihet.*

31. Neni 41 - Refuzimi i një kërkesë,

- *të riformulohet titulli dhe përmbajtja në mënyrë që të përcaktohen qartë të drejtat e aplikantit në rastet e refuzimit të kërkesës për licencim.*

32. Neni 43 - Forcimi i zbatimit të ligjit

- *ky nen konsiderohet i panevojshëm prandaj duhet të fshihet.*

33. Neni 46 - Kontraktimi me persona të papërshtatshëm,

- *paragrafi 1 dhe 2 duhet të plotësohen dhe riformulohen, me qëllim të përcaktimit të parakushteve që duhet plotësuar nga personi që mëton të hyjë në marrëveshje eventuale me personin e licencuar.*

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

34. Neni 51 - Ndalimi dhe marrja në pyetje e personit të dyshuar për shkeljen e ligjit ,

- *kërkohet riformulim i titullit dhe përmbajtjes së nenit.*

35. Neni 52 - ATK-ja dhe Policia e Kosovës –

- *Titulli duhet të riformulohet.*
- *Paragrafi 2 dhe paragrafi 5 i nenit, konsiderohen të panevojshëm prandaj duhet të fshihen, ndërsa*
- *paragrafi 4, bëhet paragraf 3 dhe duhet të përcaktoj kompetencat e Doganës së Kosovës në zbatim të dispozitave të këtij ligji.*

36. Neni 53 - Marrëveshjet, kontratat dhe qiratë –

- *ky nen konsiderohet i panevojshëm prandaj duhet të fshihet.*

37. Neni 55 - Fitimet personale materiale ose konflikti i interesit-

- *ky nen konsiderohet i panevojshëm prandaj duhet të fshihet.*

38. Nenet 57-63,

- *nuk kanë tituj. (Neni 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 i U.A. Nr. 03/2013 përcakton që secili nen duhet të ketë titullin).*

39. Neni 60 –

- *duhet titulluar neni, dhe*
- *duhet të rishqyrtohen kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit në mënyrë që zbatimi praktik i dispozitës të jetë më i lehtë.*

40. Neni 61-

- *duhet titulluar neni ndërsa*
- *paragrafi 3 i tij duhet të ri-formulohet dhe të ndahet në nën-paragrafë.*

41. Neni 64 dhe 65

- *duhet të fuzionohen në një nen të vetëm.*
- *për këtë nen, kërkohet nga Ministri i Financave nxjerrje e aktit nënligjor .*

42. Neni 66 -duhet titulluar neni

- *të riformulohet, posaçërisht nën-paragrafët: 2.3; 2.4 dhe 2.6. si dhe paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni.*

43. Neni 70

- *të rishqyrtohen kushtet për organizatorët e basteve ngase ligji aktual është shoqëruar me shumë probleme, posaçërisht të natyrës teknike.*

44. Neni 75 –

- *konsiderohet i panevojshëm (duhet fshirë) ngase detyrimet tatimore përcaktohen me ligjet për tatimet direkte, të aplikueshme në Republikën e Kosovës.*

45. Neni 76 - Ndëshkimet për mos licencim ,

- *vlera e gjobave të rishqyrtohet për arsye se administrimi i ndëshkimeve nga ATK përcaktohet nga fakti që ndëshkimet përbëjnë një mjet të rëndësishëm të administratës tatimore për të ndjekur misionin e vet të mbledhjes së efektshme të të hyrave për Buxhetin e Kosovës. Ndëshkimet mbështesin atë mision vetëm nëse ato rrisin përmbushjen vullnetare.*

46. Neni 77 - Ndëshkimet për shkelje të dispozitave ligjore,

- *vlera e gjobave të rishqyrtohet.*

47. Neni 79 - pezullimi ose revokimi i një licence –

- *të riformulohet përmbajtja e nenit.*

Përpos ndryshimeve të nevojshme, të sipërshënuara, Grupi punues e vlerëson me interes edhe fushatën mediale për sensibilizimin e opinionit publik për Lojërat e Fatit në Kosovë, impaktin e tyre në aspektin fiskal dhe të zhvillimit socio-ekonomik, me qëllim të përirësimit të perceptimit aktual publik.

3.3. Opsioni 3

Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit që nënkupton se problemi “është tek qasja dhe jo tek ligji”, vlerësohet i pamjaftueshëm dhe si i tillë nuk do t'i tejkalonte problemet ekzistuese me të cilat ballafaqohet kjo veprimtari.

Përpos ndryshimeve të nevojshme, të sipërshënuara vlerësohet me interes edhe fushata mediale për sensibilizimin e opinionit publik për Lojërat e Fatit në Kosovë, impaktin e tyre në aspektin fiskal dhe të zhvillimit socio-ekonomik, me qëllim të përmirësimit të perceptimit aktual publik.

Për ndryshimin e qasjes ekzistuese të zbatimit, është me interes dhe e domosdoshme ndërmarrja e masave si në vijim:

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

- Një fushatë mediale për përmirësimin e përceptimit aktual publik përmes sensibilizimit të opinionit publik për Lojërat e Fatit në Kosovë, me qëllim të sqarimit rreth impaktit të tyre në aspektin fiskal dhe të zhvillimit socio-ekonomik;
- Memorandume bashkëpunimi në mes të ATK-së dhe organeve të tjera në funksion të zbatimit të ligjit,
- Ngritja e mëtejme e kapaciteteve operacionale të ATK-së.

KAPITULLI 4

IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË ARDHSHME

Përcaktimi për opcionin e Ndryshimit të politikës do të manifestohet me ndikime të aspektit ekonomik dhe shoqëror.

Ndikimet ekonomike do të shprehen përmes:

- Rritjes së numrit aktual të vendeve të punës- *fuqizimi i kapaciteteve operationale të Subjekteve të LF nënkupton rritjen e nevojës për angazhime shtesë të fuqisë punëtore,*
- Rritjen e numrit të bizneseve të reja- *përmirësimi i klimës së të bërit biznes nënkupton shtimin e numrit të bizneseve të reja;*
- Uljen e ngarkesave administrative për bizneset- *kohëzgjatja e validitetit të licencave dhe eliminimi i taksës së akcizës do të ul ndjeshëm ngarkesat administrative për bizneset;*
- Investimeve të huaja direkte- *përmirësimi i klimës së të bërit biznes nënkupton shtimin e investimeve të huaja direkte;*
- Konkurrencës lojale në treg- *kuadri i ri ligjor do të jetë në funksion të konkurrencës lojale në treg;*
- Rritjen e përgjithshme ekonomike- *të gjitha ndikimet e sipërpërmendura të natyrës ekonomike do të mundësojnë rritjen e përgjithshme ekonomike të vendit.*

Ndikimet shoqërore do të shprehen përmes:

- Uljes së shkallës së papunësisë- *fuqizimi i sektorit të Lojërave të Fatit do të krijoj vende të reja të punës, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte, përmes të hyrave shtesë në buxhet;*
- Ngritjes së mirëqenies së përgjithshme- *kontributi i të hyrave shtesë në buxhet, në mënyrë prporcionale, krijon parakushte për ngritjen e mirëqenies së përgjithshme;*
- Mundësi më të mëdha për investime në skema sociale, edukim, sport, siguri dhe shëndetësi publike , etj. *fuqizimi i sektorit të Lojërave të Fatit do të krijoj mundësi për investime direkte në fusha të caktuara, si: skema sociale, edukim, sport, kulturë, etj.*
- Uljes së përgjithshme të kriminalitetit, dhunës në familje, etj.- *ngritja e mirëqenies së përgjithshme ndikon në mënyrë direkte në uljen e sjelljeve devijante të shoqërisë.*

Vlen të theksohet që opsioni i rekomanduar nga Grupi punues, pra, hartimi i ligjit të ri për Lojërat e Fatit, nuk parasheh kosto shtesë financiare, marrë parasysh që ndryshimet kryesore që duhet të bëhen janë kryesisht të fokusuar në problemet e harmonizimit të ligjit, ato teknike dhe referenciale, si dhe evitimi i problemeve tjera gjatë zbatimit, si dhe marrë parasysh që opsioni i rekomanduar nuk do të kërkoj krijimin e funksioneve të reja të detyrave plotësuese për institucionet publike.

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Figura 8: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit aktual të vendeve të punës, • Rritja e numrit të bizneseve të reja • Ulja e ngarkesave administrative për bizneset, • Investime të huaja direkte • Konkurrencë lojale në treg • Rritje e përgjithshme ekonomike.
Ndikimet shoqërore	<ul style="list-style-type: none"> • Ulja e shkallës së papunësisë, • Ngritja e mirëqenies së përgjithshme, • Mundësi më të mëdha për investime në skema sociale, edukim, sport, siguri dhe shëndetësi publike , etj. • Ulje e përgjithshme e kriminalitetit, dhunës në familje, etj.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori
Ndikimet në të drejtat themelore	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori
Ndikimi gjinor	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori
Ndikimet tek të rinjtë	<p>Të hyrat shtesë në Buxhetin e Republikës mundësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngritje të cilësisë së edukimit të tyre profesional, • Mundësi më të mëdha për sport, kulturë dhe rekreacion, • Ulje e nivelit të papunësisë, • Ngritje e mirëqenies së përgjithshme, etj.
Ndikimet në ngarkesën administrative	<p>Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori</p> <p><i>Me opsionin e rekomanduar, barra tatimore për Operatorët e Lojërave të Fatit do të jetë më lehtë e përballueshme për faktin që ligji i ri:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • do të jetë më i lehtë, më i drejtë dhe më i akceptueshëm; • do të sigurojë barazi në treg duke eliminuar konkurrencën jolojale; dhe • do të përmirësoj perceptimin publik i cili do të jetë forcë shtytëse për këtë industri.
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Figura 9: Të hyrat në Buxhetin e Kosovës nga Taksa e akcizës :

Të hyrat e taksës së akcizës nga lojërat e fatit		
Vitet	Taksa e akcizës (€)	Pagesa (€)
2014	<i>10,712,644.92</i>	<i>10,712,644.92</i>
2015	<i>10,803,238.13</i>	<i>10,803,238.13</i>
2016	<i>11,854,028.15</i>	<i>11,854,028.15</i>
2017	<i>13,925,847.00</i>	<i>13,925,847.00</i>
Janar-Qershor /2018	<i>7,673,787.23</i>	<i>7,673,787.23</i>

KAPITULLI 5
KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI

Gjatë përgatitjes së Strategjisë Legjislative për vitin 2018 dhe Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017 – 2021, për qëllime informative janë mbledhur informata me metoda direkte dhe indirekte, përfshirë këtu edhe çështjet që kishin të bëjnë me zbatimin e legjislacionit tatimor.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së politikës respektivisht Koncept Dokumentit, vlen të theksohet komunikimi dhe konsultimi i Grupit Punues me personat që ndikohen nga problemi respektivisht me përfaqësues të grupeve të interesit si dhe ekspertë të fushës.

Me këtë rast duhet të përmendim takimet me :

- Departamentin e Lojërave të Fatit në kuadër të ATK-së;
- “Lotaria e Kosovës” Sh.a. respektivisht drejtorin e saj;
- “Shoqatën e Lojërave të Fatit në Kosovë” respektivisht kryetarin e saj si dhe
- Përfaqësues të Shoqatës Gjermane për Bashkëpunim Internacional GIZ -Zyra në Prishtinë,

Takimet me palët e sipërpërmendura kishin për qëllim :

- informimin e drejtpërdrejtë për synimet dhe objektivat e politikës së re;
- rritjen e transparencës në vendimmarrje të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- ofrimin e mundësisë për adresimin e propozimeve, vërejtjeve dhe rekomandimeve të tyre, në funksion të eliminimit të dobësive të ligjit aktual.

Komunikimet janë realizuar nga personi përgjegjës për KD përmes takimeve të drejtpërdrejta ndërsa vërejtjet dhe rekomandimet nga ana e tyre janë dorëzuar në formë të shkruar, të cilat i janë prezantuar grupit punues për shqyrtimin dhe inkorporimin e tyre, në rastet kur janë vlerësuar të drejta dhe të arsyeshme.

Emërues i përbashkët i të gjitha takimeve është konstatimi i nevojës për ndryshime imediate të ligjit aktual si dhe vlerësimi i transparencës në vendimmarrje të Qeverisë.

Figura 10: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për koncept dokumentin e Lojërave të Fatit

Procesi i konsultimit synon:					
<ul style="list-style-type: none"> - motivimin e palëve të interesuara që të ofrojnë pikëpamjet e tyre ; - pjesëmarrjen maksimalëve të palëve të interesit në procesin e konsultimit; - përmirësimin e përkufizimit të problemit nëpërmjet konsultimit të fokusuar 					
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati kohor	Personi përgjegjës
Diskutime specifike fillestare lidhur me politiken	-Lotaria e Kosovës; -Shoqata e Lojrave të Fatit	Takime pune	Përmes tel. & e-mail adresa	Data e takimeve	GP

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Diskutimi i parë i përgjithshëm publik me palët e interesuara (Problemi, Objektivat dhe Opsionet)	Të gjitha palët e interesuara	Takim publik	Ftesa pjesëmarrësve dhe njoftimi në ëebfaqe	Shtator-Tetor2018	GP
Shqyrtimi i pikepamjeve të inst. tjera lidhur me politiken e propozuar	Sipas neni 7 të RrPQ 09/2011, vecanerisht PK dhe komunitat	Konsultimi paraprak	Konsultimi me shkrim përmes e-mail	Shtator – 2018	GP
Shqyrtimi i pikëpamjeve të palëve të interesuara lidhur me politiken e propozuar	Të gjitha palët e interesuara	Konsultimi publik me shkrim	Konsultim me shkrim përmes e-mail dhe Publikimi i dokumentit në portalin për konsultim publik	Tetor 2018	GP / Kordinatori për konsultim publik i MF

KAPITULLI 6 KRAHASIMI I OPSIONEVE

Grupi punues gjatë hartimit të koncept dokumentit ka shqyrtuar opsionet si në vijim:

Opsioni 1: Opsioni pa ndryshime (gjendja status quo)

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Opsioni 1, nënkupton mos ndryshimin e ligjit aktual që nënkupton ruajtjen e status quo-s dhe rrjedhimisht, më pak të hyra në buxhet.

Opsioni 2, parasheh tejkalimin e situatës ekzistuese përmes hartimit të ligjit të ri me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të përshtatshëm të të bërit biznes dhe njëkohësisht rritjes së përmbushjes së obligimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve.

Hartimi i infrastrukturës së re dhe të përshtatshme ligjore do të ndikonte në kontrollin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të lojërave të fatit nga ana e organeve të zbatimit të ligjit, me ç'rast aktiviteti në fjalë do të vëhej në funksion të drejtpërdrejtë të zhvillimit ekonomik të vendit. Pra, me anë të një baze ligjore të mirëfilltë dhe kontrolluese nga ana e institucioneve përgjegjëse do të eliminoheshin dobësitë e sipërpërmendura të kuadrit ekzistues ligjor si dhe paragjykimet shoqërore, të nderlidhura me perceptimin publik për bizneset që i takojnë kësaj fushe.

Gjithashtu, kuadri i ri ligjor do të mundësonte:

- Hartimin e tij në përputhje me kërkesat standarde të Udhëzimit për hartimin e akteve normative;
- Eliminimin e dispozitave ligjore:
 - jo të plota,
 - kontradiktore ,dhe
 - atyre që krijojnë ngarkesa të panevojshme (të nderlidhura me procedurat e licencimit dhe rilicencimit).

Përfitimi neto përmes opsionit të dytë do të jetë shumë më i madh, krahasuar me dy opsionet tjera.

Opsioni 3 - Opsioni i adresimit të problemeve me anë të ndryshimit të qasjes së zbatimit nga ana e akterëve të përfshirë. Grupi punues vlerëson që ndryshimi i mqasjes duke e ruajtur kuadrin ligjor ekzistues është i pamjaftueshëm për sanimin e problemeve dhe ndryshimin e gjendjes në kuptimin pozitiv.

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Prandaj, nga konstatimet e mësipërme rezulton që vetëm opsioni2 gjegjësisht opsioni i ndryshimit të politikës mundëson tejkalimin e problemeve ekzistuese respektivisht është zgjidhje afatgjate.

Figura 11: Plani i zbatimit për Opsionin 2

Qëllimi i politikës	Ndryshimi i Ligjit për Lojërat e Fatit								Shifra e kostos së pritur	
Objektivi strategjik	<ul style="list-style-type: none"> • Ulja e informalitetit , • Përshpejtim të zhvillimit ekonomik përmes rritjes së të hyrave buxhetore • Përmirësimi i klimës të të bërit biznes në Kosovë. 									
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës									
Objektivi Specifik 1 Ulja e informalitetit	Produkti 1.1	Më shumë të hyra në buxhet								
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës		
		Aktiviteti 1.1.1 Zbatimi në praktikë i Ligjit të Ri	2019	2020	2021			DLF-ATK	Rritje për 50%	
		Aktiviteti 1.1.2 Fushatë mediale	2019	2020	2021			ATK	%	
	Aktiviteti 1.1.3 Ngritje e kapaciteteve op. të DLF	2019					ATK			
	Produkti 1.2									
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës		
Aktiviteti										

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

		1.2.1							
Objektivi Specifik 2	Produkti 2.1	Etj.							
Përshejtim të zhvillimit ekonomik përmes rritjes së të hyrave buxhetore	Produkti Përmirësi m i gjendjes ekonomik o-seciale	Etj.							
Objektivi Specifik 3	ProduktiN .1	Etj.							
Përmirësimi i klimës të të bërit biznes në Kosovë	Më shumë investime direkte								

[Përmbledhni shkurtimisht Opsionin 3. Përkruani se si ky opsion trajton problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e identifikuara në Pemën e Problemit.]

Figura 12: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Metoda e krahasimit:			
Ndikimet relevante pozitive	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit	Opsioni 3:
Nd. ekonomike	Pa ndikim	pozitiv	pozitiv
Ndikimet relevante negative			
Kostot relevante			

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor									
Përfundimi									

KAPITULLI 7 KONKLuzionet dhe Hapat e Ardhshëm

Grupi punues, duke marr në konsideratë:

- objektivat e Qeverisë në funksion të zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik,
 - gjendjen ekzistuese në lëmin e Lojërave të Fatit në Kosovë,
 - mangësitë që përmban legjislacioni aktual, në aspektin e formës dhe të përmbajtjes , konkludon se :
1. Nisur nga konstatimet e mësipërme, problemi kryesor që e cilëson ligjin aktual është **problemi i zbatimit në praktikë të tij**, për arsytet e përmendura në këtë koncept dokument.
 2. Qëllimi i përcaktuar në këtë koncept dokument synohet të realizohet përmes tri objektivave:
 - Sistematizimi i duhur i dispozitave ligjore në fuqi;
 - Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit me rekomandimet e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare; dhe
 - Evitimi i pengesave në zbatimin e legjislacionit tatimor në përgjithësi.

Realizimi i sukseshëm i këtyre objektivave do të rezultonte me rritjen e të hyrave buxhetore, si rezultat i eliminimit të evazionit fiskal, zvogëlimit të ekonomisë informale dhe rritjes së aktiviteteve ekonomike investuese, prodhuese dhe eksportuese, pa ndonjë rritje të normave të tatimeve dhe doganave, por duke bërë shtrirjen horizontale të sistemit fiskal. Njëherit, do të sigurohej edhe vazhdimësia e përmirësimit të mjedisit të të bërit biznes.

3. Ndryshimi i politikës ekzistuese bëhet duke hartuar kuadrin e ri ligjor për Lojërat e Fatit, përmes të cilit do të përcaktoheshin kriteret dhe procedurat për fushëveprimin e Lojërave të Fatit në Kosovë. Pra, grupi vlerëson që zgjidhje është vetëm Opsioni 2- Ndryshimi i politikës.
4. Përfitimi neto përmes opsionit të dytë do të jetë shumë më i madh, krahasuar me dy opsionet tjera.

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

5. Grupi nuk parashef ndikime negative. Përkundrazi, ndikimet pozitive të pritshme janë të natyrës ekonomike si dhe të natyrës shoqërore, të listuara në Kapitullin 4 të këtij koncept dokumenti.
6. Hartimi i ligjit të ri për Lojërat e Fatit, nuk parasheh kosto shtesë financiare, marrë parasysh që ndryshimet kryesore që duhet të bëhen janë kryesisht të fokusuara në problemet e harmonizimit të ligjit, ato teknike dhe referenciale, si dhe evitimi i problemeve tjera gjatë zbatimit, si dhe marrë parasysh që opsioni i rekomanduar nuk do të kërkojë krijimin e funksioneve të reja të detyrave plotësuese për institucionet publike.
7. Procesi i konsultimit është realizuar në përputhje me Rregulloren (QRK) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, të miratuar në mbledhjen e 86 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 06/86, datë 29.04.2016.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	PO	Jo	I lartë/i ulët I ulët	I lartë/i ulët I ulët	I ulët
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		JO			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?	PO		I ulët	I ulët	I ulët
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	PO		I ulët	I ulët	I ulët
	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?	PO		I ulët	I ulët	I ulët
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		JO			
Bërja e biznesit	A do të lejohen në treg produkte/SHËRBIME të caktuara?	PO		I lartë	I lartë	I lartë
	A do të detyrohen bizneset të mbyllin?		JO			
	A do të krijohen biznese të reja?	PO		i ulët	i ulët	i ulët
	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		JO			
Ngarkesa administrative	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?	PO		I lartë	I lartë	I lartë
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		JO			
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të		JO			
			JO			

¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

eksportit?							
A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?	JO						
A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?	JO						
A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?	JO						
A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?	JO						
A do të rriten investimet nga diaspora?	JO						
A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?	JO						
A do të rriten investimet e huaja direkte?	PO	I ulët	I ulët			I ulët	I ulët
A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?	JO						
A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?							
A do të ulët çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?							
A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?	JO						
A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?	JO						
A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?	PO	I lartë	I lartë			I lartë	I lartë
A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?	PO	I ulët	I ulët			I ulët	I ulët
A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?	JO						

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?						
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?						
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	PO		I lartë		I lartë	I lartë
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		JO				
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?	PO		I ulët		I ulët	I ulët
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		JO				

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritsëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	PO		I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	I ulët
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		JO			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?	PO		I ulët		
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?	PO		I ulët		
Ndikimet shoqërore rajonale	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	PO		I ulët		
	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		JO			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?	PO		I ulët	I ulët	I ulët
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		JO			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		JO			
	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?	PO		I ulët	I ulët	I ulët
Përfshirja sociale	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		JO			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		JO			
	A do të ketë ndikim në financimin apo	PO		I ulët	I lartë	I lartë

² Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Arsimi	organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?								
	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?				JO				
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?				JO				
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?				JO				
Kultura	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?				JO				
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?				JO				
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?				JO				
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?				JO				
Qeverisja	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?				JO				
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?	PO				I ulët		I ulët	
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?	PO				I ulët		I ulët	
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?				JO				
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?				JO				
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	PO				I ulët		I ulët	
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	PO				I ulët		I lartë	
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?				JO				
Qeverisja	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?				JO				

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Shëndeti dhe siguria publike ³	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?			I ulët	I lartë	I lartë	
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?	JO					
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?	JO					
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?	JO					
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?	JO					
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?	JO					
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?						
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?	PO			I lartë	I lartë	I lartë
	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?	PO			I ulët	I ulët	I ulët
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?	PO			I ulët	I ulët	I ulët
A ndikohet në nivelet e korrupsionit?	PO			I ulët	I lartë	I lartë	
A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	PO			I ulët	I ulët	I ulët	
A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimi?		JO					

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?	JO	JO	I lartë/i ulët		
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?	JO	JO			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?	JO	JO			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?	JO	JO			
Cilësia e ajrit	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?	JO	JO			
	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?	JO	JO			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?	JO	JO			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?	JO	JO			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?	JO	JO			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?	JO	JO			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?	JO	JO			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?	JO	JO			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?	JO	JO			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në	JO	JO			

KONCEPT DOKUMENTI PËR LOJËRAT E FATIT

Mbeturinat dhe rriciklimi	shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?						
	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?	JO					
Përdorimi i burimeve	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?	JO					
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?	JO					
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?	JO					
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?	JO					
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjatat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?	JO					
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?	JO					
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?	JO					
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?	JO					
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?	JO					
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?	JO					
	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?	JO					
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?	JO					
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?	JO					

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		JO		I lartë/i ulët	
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve? A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi? A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje? A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes? A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë? A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes? A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		JO			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale? A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara? A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	PO			I ulët	I ulët
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		JO			
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë? A ndikon opsioni në lirinë për të bërë		JO			

